



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1096/2 prot.

Tiranë, më 07. 08. 2025

**V E N D I M**

**Nr. 186, datë 07. 08. 2025**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 162 Regj., datë 16.07.2025, të shtetasit N. M., kundër Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Bashkisë Lezhë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të bindjeve politike<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Bazuar në ankesën dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, N. M., parashtron ndër të tjera se është anëtarë i Partisë Demokratike dhe pjesëmarrës në të gjitha takimet e zhvilluara nga ky subjekt politik. Deri në vitin 2013, ai ka ushtruar detyrën e punonjësit të Policisë së Shtetit. Me ardhjen në pushtet të Partisë Socialiste në vitin 2013, ai është larguar nga detyra dhe një vit më pas ka nisur të ushtrojë aktivitetin e tij privat në plazhin e Kunes, në Shëngjin, Lezhë, në një tokë të një të afërmi, i cili ia ka dhënë në përdorim. Prej 12 vitesh është lejuar nga institucionet përgjegjëse për të shfrytëzuar hapësirën e plazhit duke vendosur çadra për pushuesit. Këtë aktivitet sipas tij, ai e ka ushtruar duke shlyer të gjitha detyrimet dhe pajisur me lejet përkatëse për shfrytëzimin e vijës bregdetare.

Si çdo vit tjetër, në muajin shkurt 2025, ankuesi sqaron se i është drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Bashkisë Lezhë dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, duke kërkuar të pajiset me lejen përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit. Në përgjigje të kërkesës së tij, Bashkia Lezhë me shkresën nr. 1738/1 prot., datë 03.03.2025, i ka sqaruar ndër të tjera

<sup>1</sup> Mbështetur në Librezën e Antarësisë Nr. 016563, datë 10.09.2000, ankuesi provon faktin që është anëtarë i subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

se: “...Referuar VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” Bashkia Lezhë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe me strukturat e Policisë Kufitare ka përgatitur hartën e stacioneve të plazheve duke marrë në konsideratë kushtet dhe kriteret sipas VKM-së të sipërcituar. Ju njoftojmë se në afërsi të pronës Tuaj, stacionet e plazhit janë publike pasi evidentohet që në afërsi të këtyre stacioneve nuk ka strukturë akomoduese...”.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, përmes shkresës nr. 1068/1 prot., datë 14.04.2025, i ka sqaruar ankuesit ndër të tjera se: “...Ushtrimi i veprimtarisë së stacioneve të plazhit rregullohet bazuar në Vendimin Nr. 649, datë 16.10.2024 të Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” i ndryshuar (në vijim VKM 649/2024).

Sipas rregullores së lartpërmendur, aplikimi për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, bëhet në portalin “e-Albania” brenda afateve të përcaktuara, në njoftimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Sipas njoftimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për sezonin turistik veror 2025, aplikimet kanë qëndruar të hapura nga data 15.1.2024 deri në datën 20.12.2024.

Aktualisht, afatet për të aplikuar për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi për sezonin veror 2025 kanë përfunduar.

Për sa më sipër, aplikimi juaj nuk mund të shqyrtohet pasi afati për aplikim për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi për sezonin turistik 2025 është mbyllur në datë 20.12.2024”.

Ndërsa, me shkresën nr. 1406/1, datë 08.05.2025, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, i ka sqaruar se: “...Ushtrimi i veprimtarisë si stacion plazhi rregullohet bazuar në VKM-në nr. 649/2024 “Për miratimin e Rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”. Procedura për aplikimin dhe miratimin e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit realizohet sipas parashikimeve të kësaj VKM-je dhe vetëm nëpërmjet sistemit e-Albania.

Për sezonin turistik 2025, ashtu si dhe në vitet e kaluara, aplikimet në sistem kanë qenë të hapura nga data 15.11.2024-20.12.2024, referuar njoftimit publik mbi hapjen e aplikimeve, të bërë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga verifikimet në sistemin e-albania nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA) konfirmohet se për sezonin veror 2025, nuk rezulton të jetë bërë asnjë aplikim nga ana juaj, brenda afatit sipërcituar.

Aktualisht, afatet për aplikim për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi për sezonin veror 2025 kanë përfunduar.

Për sa më sipër, kërkesa juaj për miratimin e lejes për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, në parcelën e plazhit me kod identifikues LE-320, për sezonin veror 2025, nuk mund të pranohet...”

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit të tij, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Bashkisë Lezhë. Gjithashtu, kërkon të lejohet

të zhvillojë aktivitetin për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi nga ana e institucioneve përgjegjëse.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkuftizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:*

Subjekti ankues, pretendimet për diskriminim nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Bashkisë Lezhë, lidhur me mosdhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, i ngre në kuadër të *“bindjeve politike”*, duke referuar tek ky shkak, se ai dhe familja e tij janë angazhuar dhe janë përkrahës të Partisë Demokratike në të gjitha aktivitetet e saj.

- Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gerrat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ....b) ..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; .....ç) .....nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;” Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet, bazuar në arsyetimin vijues:

- Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim sa i përket mosdhënies së lejes për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit.

Këshilli i Ministrave përmes Vendimit nr. 649, datë 16.10.2024, ka miratuar Rregulloren “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”. Në nenin 7 të saj, janë përcaktuar kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, ku ndër të tjera parashikohet se:

“1. Në stacionin e plazhit ushtrojnë veprimtarinë subjektet që plotësojnë kriteret e kësaj rregulloreje dhe që lidhin një kontratë qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit, në varësi të kapacitetit të strukturës akomoduese, si dhe, rast pas rasti, njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

2. Në rastin e kërkesave të projekteve me potencial strategjik, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, apo kërkesave të investitorëve në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, kontrata për përdorimin e hapësirës së plazhit lidhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.

3. Kur veprimtaria e stacionit të plazhit ushtrohet nga subjekt privat, subjekti përmbush kriteret, si më poshtë:

a) Të jetë i regjistruar si person fizik/tregtar apo juridik për ushtrimin e veprimtarisë, si strukturë akomoduese;

b) Të disponojë një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para/në afërsi të strukturës akomoduese;

c) Të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore qendrore dhe detyrimet vendore;

ç) Të ketë një plan operimi për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke përfshirë kushtet minimale dhe kërkesat e sigurisë për stacionin e plazhit.

4. Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për dhënie në përdorim të stacionit të plazhit është GTSHA-ja, i cili ka në përbërje 5 (pesë) përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe asistohet nga sekretariati teknik. Përbërja nominale caktohet nga titullari i agjencisë.

5. GTSHA-ja, në dhënie në përdorim të hapësirës së plazhit, për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit:

a) i jep përparësi sipas radhës:

i. subjektit që disponon një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para strukturës akomoduese;

ii. subjektit që disponon një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi në afërsi të strukturës akomoduese;

b) cakton dhe miraton numrin e çadrave, në varësi të numrit të dhomave të deklaruara nga subjekti. Për përcaktimin e numrit të çadrave GTSHA-ja mban në konsideratë numrin e dhomave të strukturës akomoduese, duke llogaritur në raportin 1 dhomë, 2 çadra.

6. Subjekti që plotëson kriteret e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, aplikon në portalin “e-Albania” për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, brenda afatit/eve të përcaktuar/a, në njoftimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

7. Në fazën e parë të aplikimit, subjekti ngarkon në portalin “e-Albania” dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e kërkesës on-line, sipas numrit përkatës identifikues të stacionit të plazhit, duke specifikuar kapacitetin e strukturës akomoduese, numrin e dhomave;

b) planin e operimit për ushtrimin e veprimtarisë, si stacion plazhi, sipas formatit të publikuar on-line;

c) foto të jashtme të qarta të strukturës akomoduese, të cilat identifikojnë strukturën akomoduese, në raport me hapësirën e plazhit, si dhe foto të qarta të hapësirës së plazhit, për të cilën aplikohet:

ç) vetëdeklarimin se subjekti është njohur me kushtet, kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe mban përgjegjësi të plotë për plotësimin dhe zbatimin tyre, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

8. GTSHA-ja, për shqyrtimin e kërkesave, ndjek procedurën e mëposhtme:

a) shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 7 (shtatë) ditëve. Në rast se konstatohet mungesë apo pasaktësi dokumentacioni, njofton menjëherë subjektin nëpërmjet portalit e-Albania për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm. Subjekti plotëson dokumentacionin e nevojshëm brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit;

b) në rast se subjekti nuk plotëson dokumentacionin brenda afatit të kërkuar, kërkesa konsiderohet si e paregjistruar dhe i kthehet subjektit bashkë me aktet e tjera nëpërmjet portalit “e-Albania”;

c) në rast se subjekti i plotëson kriteret dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton i plotë, GTSHA-ja njofton subjektin nëpërmjet portalit “e-Albania” për fazën e dytë të procedurës dhe njofton elektronikisht njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, që subjekti është kualifikuar në fazën e parë.

9. Në fazën e dytë të aplikimit subjekti, brenda datës 31 mars, ngarkon në portalin “e-Albania” dokumentacionin e mëposhtëm:

a) planvendosjen përkatëse të stacionit të plazhit, e cila përgatitet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, ku specifikohet numri i çadrave, duke mbajtur në konsideratë distancat e parashikuara në këtë rregullore dhe sipërfaqen konkrete, e cila nuk duhet të tejkalojë numrin e çadrave të miratuara të stacionit të plazhit dhe të jetë në mënyrë perpendikulare me bregun e detit/liqenit. Në rastet kur në parcelë, objekt kërkesë, është miratuar paraprakisht më shumë se një subjekt përfitues, NJVV-ja mirëpërcakton planvendosjen përkatëse të stacionit të plazhit për secilin prej tyre;

b) gjenerimin e mandatpagesës vjetore të sipërfaqes së stacionit të plazhit nga ana e NJVV-së, si palë përfituese, sipas tarifave vendore në fuqi, ku detajohet detyrimi financiar vjetor për përdorimin e sipërfaqes së stacionit të plazhit dhe vërtetimi i pagesës së kryer nga ana e subjektit;

c) vërtetimin nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore qendrore dhe detyrimet vendore;



*ç) marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesin e plazhit, shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit, e vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes, sipas afatit të parashikuar në pikën 14, të këtij neni.*

*10. GTSHA-ja është përgjegjëse për sigurimin e dokumentacionit, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 3, të këtij neni.*

*11. Pas plotësimit të dokumentacionit të mësipërm, GTSHA-ja miraton në portalin “e-Albania” aplikimin përkatës dhe AKB-ja njofton menjëherë subjektin dhe NJVV-në për nënshkrimin e kontratës. Modeli kontratës tip që AKB-ja nënshkruan me subjektin është sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.*

*12. Dorëzimi i hapësirës së plazhit bëhet, si më poshtë vijon:*

*a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, topografi i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore ndan me procesverbal në terren koordinatat e stacionit të plazhit dhe njofton Policinë Bashkiake për monitorimin e veprimtarisë;*

*b) një kopje e procesverbalit depozitohet pranë zyrës qendrore të AKB-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti hartimit të tij.*

*13. Kontrata për dhënien në përdorim të hapësirave të plazhit nënshkruhet me afat nga 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet, sipas vendimmarrjes të KMST-së.*

*14. Periudha, brenda të cilës ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit, është nga 1 maj deri më 15 nëntor të çdo viti dhe kur subjekti ushtron veprimtarinë ofron të gjitha shërbimet dhe përmbushen të gjitha kushtet minimale, të përcaktuara në bazë të tipologjisë së plazhit ku do të ushtrohet aktiviteti”.*

Në këto kushte, bazuar në përcaktimet ligjore të VKM-së sipërcituar, Komisioneri vlerëson se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Bashkia Lezhë, nuk kanë konsumuar asnjë shkelje apo trajtim të padrejtë e të pafavorshëm të ankuesit, lidhur me mosdhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, pasi në analizë të VKM-së sipërcituar rezulton se:

- *Së pari, në zbatim të nenit 7, pika 3/b) të VKM-së, ankuesi nuk provon se disponon strukturë akomoduese për përfitimin e lejes për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit;*
- *Së dyti, në zbatim të nenit 7, pika 6 të VKM-së, ankuesi nuk provon se ka aplikuar në portalin “e-Albania” për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, brenda afatit/eve të përcaktuar/a, në njoftimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.*

Nga provat e administruara, ankuesi i është drejtuar me shkresë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Bashkisë Lezhë, në muajin shkurt 2025, ndërkohë afatet e përcaktuara, në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për aplikim për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, kanë qenë nga data 15.11.2024-20.12.2024. Për më tepër, ankuesi nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë provë apo fakt se ai ka paraqitur aplikimin e tij përmes portalit e-albania, brenda afateve të përcaktuara në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Për pasojë, ky kërkim i ankuesit, haptazi i pabazuar, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

Për rrjedhojë, nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. *Ankesa nuk pranohet nëse: ....ç) është haptazi e pabazuar...*”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.

Së dyti – *Lidhur me shkakun e bindjeve politike të pretenduar nga subjekti ankues.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “*Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëlllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta*”, si dhe “*Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë*”<sup>3</sup>

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi respektivisht edhe për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

---

<sup>3</sup> Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përgjashtimit* ose *preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, nuk rezulton që nga ana e ankuesit të jenë ngritur pretendime ose të jetë provuar diferenca në trajtim nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Bashkisë Lezhë, apo dështimi i këtyre të fundit për të trajtuar ndryshe rastin, për shkak të bindjeve politike të ankuesit.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkakun sipërcituar/bindjet politike, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon një shkak të mbrojtur, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkakun e pretenduar, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi është bindja politike e ankuesit.

Pala ankuese nuk parashtroi fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucioneve përgjegjëse/ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Bashkia Lezhë, që të jenë motivuar apo nxitur nga bindjet politike të tij.

Gjithashtu, nga ana e ankuesit është referuar se gjatë 12 viteve të fundit, ai është pajisur me leje për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, nga ana e Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Bashkia Lezhë. Nga provat e administruara, rezulton se përmes shkresës nr. 635/1 prot., datë 24.03.2023, Agjencia Kombëtare e Bregdetit i është drejtuar Bashkisë Lezhë duke e njoftuar për vijimin e procedurave për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit. Në këtë kuadër dhe duke ju referuar pretendimeve të tij, ankuesi gjatë 12 viteve të fundit është pajisur me leje për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit dhe ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, nga ana e institucioneve sipërcituar. Për më tepër, rezulton se edhe gjatë vitit 2023, ankuesi është pajisur me leje nga po të njëjtët institucione, të cilat janë drejtuar nga të njëjtët persona. Pra, edhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Bashkia Lezhë, kanë patur të njëjtët drejtues të cilët e kanë pajisur më parë me lejen për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi. Në këtë kuptim, nuk provohet se trajtimi i diferencuar që pretendon ankuesi ka ardhur si pasojë e bindjeve politike të tij, pasi të paktën në 3 vitet e fundit nuk ka patur ndryshime në drejtimin e institucioneve ndaj të cilëve ka paraqitur ankesën.



Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “4. *Ankesa nuk pranohet nëse: ç) .....nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/ të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues N. M., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindjet politike)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)